



VENDIM

Nr.91 Datë 03.12.2009

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË OST SH.A PËR VITIN
2009 - 2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neni 11 i Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 03.12.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a dhe u njoh me informacionin e përgatitur nga grupi i punës për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009 – 2010,

Konstatohet se:

Aplikimi i OST sh.a për planin e investimeve për vitin 2009 dhe 2010 është në përputhje me kërkesat e neneve 9 dhe 13 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike,

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve

Vendos:

1. Të miratojë planin e investimeve të OST sh.a për vitin 2009 – 2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST Sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.91 Datë 03.12.2009

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË OST SH.A PËR VITIN
2009 - 2010**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____